


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.11.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-2432/12, për Zyrtarin e Lartë, z. Asllan Vitaku, Kryesues i Bordit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dëshmuar se ka bërë ndryshimet e kërkuar nga Agjencia kundër Korrupsionit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të Ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marre, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-2432/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Asllan Vitaku, Kryesues i Bordit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Kryesues i Bordit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, ka qenë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK), si person i autorizuar dhe pronarë në kompaninë private "N.P.N Asllan&Sons" e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 21.08.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme

të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z.Asllan Vitaku, ka komunikuar me zyrtarët e Agjencisë dhe e ka konfirmuar se e ka marrë shkresën njoftuese dhe se, do të vij në Agjenci për ta sqaruar këtë situatë ku dyshohet për Konflikt të mundshëm të Interesit.

Pas kësaj Agjencia kundër Korrupsionit, me datën 21.10.2012 i ka dërguar z. Asllan Vitaku, shkresën e dytë paralajmëruese për konstatim të situatës së konfliktit të interesit pasi që ai nuk është lajmëruar në afatin e parë, dhe e ka njoftuar se nëse brenda afatit 15 pesëmbëdhjetë ditore, nuk shmanget nga kjo situatë Agjencia do të të veproj sipas nenit 18.8 të ligjit Nr.04/L-051.

Zyrtari i Lartë, z.Asllan Vitaku, menjëherë pasi ka marrë shkresën e dytë paralajmëruese ka ardhë në Agjenci dhe është arsyetuar se për disa çështje private nuk ka mundur të vije, dhe të bëjë ndryshimet që do të shmangeshin nga situata e konfliktit të interesit, të cilën e ka konstatuar AKK-ja, mirëpo është arsyetuar se brenda afatit ligjor, do të veprojë sipas kërkesës së Agjencisë, për ta shmangur këtë situatë.

Me datën 05.11.2012, z.Asllan Vitaku, Kryesues i Bordit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, ka njoftuar Agjencinë dhe ka sjellë dëshmitë nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve ku dëshmon se është larguar nga funksioni i personit të autorizuar dhe ka mbetur vetëm pronarë, në biznesin e tij.

Zyrtari i lartë z.Asllan Vitaku, Kryesues i Bordit në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej pasi që ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia kundër Korrupsionit dhe nuk ushtron me pozitën e personit të autorizuar në kompaninë private "N.P.N Asllan&Sons" dhe mbetet vetëm në funksionin e Kryesuesit të Bordit në Kompaninë Publike për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

